



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.547/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaçi dhe Faton Ademi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Elona Kastrati me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet i palejuar apeli A.nr.547/2021 i dates 02.03.2021, e paraqitur nga Elona Kastrati, me vendbanim në Gjermani paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, pasi që për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 136/2021 të datës 05.02.2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Elona Kastrati të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 26 shkurt 2021, me të cilin thekson se KQZ-ja nuk arriti që ta lajmëroj në telefon për konfirmim për pjesëmarrje në zgjedhje. E njëjta thekson se metoda e thirrjes në telefon për konfirmim është e paligjshme.

Paneli, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Elona Kastrati, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar më parë nga parashtruesja e njëjtë e paraqitur me datën 03.02.2021 e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 136/2021 të datës 05.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Elona Kastrati është **çështje e gjykuar “res iudicata”**.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 136/2021 të datës 05.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në apel.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 547/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 18 par 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.